



RAPORT MONITORIMI

# Turizmi VS Covid19

GUSHT-TETOR 2021



AUTOR  
**STIVEN SHALA**

QENDRESA  
QYTETARE



[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

## Turizmi VS Covid 19

Turizmi është kthyer tashmë në një industri të fuqishme në Shqipëri, me një ndikim në formimin e Prodhimit të Brendshëm Bruto si dhe në nxitjen e vendeve të reja të punës. Gjatë këtyre pothuajse dy vite pandemi, turizimi është një nga sektorët që u dëmtua më rëndë, realitet i parë edhe në vende të tjera të botës. Fatkeqësisht edhe verën që lamë pas, Shqipëria nuk arriti të përfitojë nga turizmi në përmasat që duhej, për shkak të masave në lidhje me covid-19, masa këto që u ndërmorën në mënyrë të pa studiuar nga Komiteti Teknik i Ekspertëve.

Me një mesatare shumë të ulët të rasteve gjatë muajve të verës, Shqipëria paraqitej në një situatë shumë të mirë epidemiologjike, duke mos pasur nevojë për masa ekstreme. Në muajin korrik, në Shqipëri kishte vetëm 1 vdekje. Ndërkohë që vendet e tjera të Rajonit ishin të hapura, Shqipëria vazhdonte akoma të kishte 'orën policore', vazhdonte të mbante të mbyllur jetën e natës si dhe të kufizonte grumbullimet mbi një numër të caktuar individësh. E në të njëjtën kohë, në Shqipëri ishte arritur imuniteti i masës duke i bërë këto masa totalisht të panevojshme.

Arritja e imunitetit të tufës sigurisht që i kushtoi Shqipërisë shtrenjtë, pasi nuk u arrit në një mënyrë të kontrolluar por kishte një kosto të lartë në jetët e humbura. E megjithatë, ky imunitet i krijoi dhe një mundësi unike për të ofruar një turizëm të sigurt, si asnjë shtet tjetër në Evropë.

Megjithëse 'jeta e natës' nuk lejohej në Shqipëri, shumë festivale u organizuan. Disa nga këto festivale nuk arritën ta merrnin 'lejën e veçantë' për të vazhduar me muzikë pas orës 23:00. Të tjerë festivale u lejuan edhe përtej orës 23:00 duke i ofruar të pranishmëve muzikë gjatë gjithë natës. Mos ndoshta përhapja e covid ndryshon nga lloji i muzikës? Për këtë gjë duhet pyetur ish-Ministri, tashmë, i Turizmit, Blendi Klosi, që njëherë e një kohë na shpjegoi si valët e muzikës përhapnin virusin.

Po kështu, klubet e natës qëndronin hapur deri në 23:00. Deri në atë orar, ato operonin me kapacitet të plotë, madje ishin dhe të mbingarkuara. Ndërkohë pas orarit, njerëzit iknin sepse komiteti e vlerësonte kështu, pra pa asnjë sens logjik. Por dhe në këtë rast, plot klube nate vazhdojnë të

operojnë edhe pas orarit të caktuar, duke mbledhur me qindra të rinj e të reja pavarësisht kufizimeve.

Siç u theksua dhe më parë, komiteti duhej të rekomandonte heqjen e këtyre masave dhe ministria duhej të vepronte me një strategji hapjeje. Në të njëjtën kohë, për të ruajtur dhe popullatën, mund të vendosej një rregull hyrjeje në Shqipëri, ku çdo turist të paraqiste ose një dëshmi vaksinimi, ose një test rapid negativ, ose një certifikatë shërimi nga covid.

Por dhe këtë herë qoftë komiteti teknik, qoftë drejtuesit e institucioneve e humbën shansin për të rikthyer normalitetin për shqiptarët dhe për të nxitur turizmin e për të zhvilluar ekonominë shqiptare që po vuan kaq shumë. Me një strategji hapjeje të mirëmenduar, çdo qytetar mund të përfitonte nga dëshira e madhe e të huajve për të udhëtuar në vende me shifra të ulëta rastesh covid.

## SI NDRYSHOI TURIZMI KËTË VIT NË DY VITE PANDEMI?

Edhe pse Shqipëria vazhdonte të kishte kufizime, turizmi duket se filloi të normalizohet këtë verë, gjithmonë duke e krahasuar me vitin 2020. Gjatë vitit të shkuar, turizmi u godit rëndë. Numri i turistëve që vizituan Shqipërinë në vitin 2020, ishte 58.5% më pak se viti 2019 sipas Institutit të Statistikave.

Në 2021, numri i turistëve u rrit në mënyrë të kënaqshme. Po të marrim në analizë muajin Gusht, shohim se numri i hyrjeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar në vitin 2021 është përafërsisht i njëjtë me numrin e hyrjeve të 2019, pra para pandemisë.

Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Gusht 2021, janë 2.185.493. Krahasuar me Gusht 2020, ku hyrjet janë 846.973, ky tregues rezulton me një rritje 2,6 herë. Numri i hyrjeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në gushtin e këtij viti është pothuajse i njëjtë me atë të Gusht 2019, ku hyrjet janë 2.256.761.

Ndërkohë, po sipas INSTAT, numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë tetëmujorit të 2021, është 4.384.072, duke u rritur me 2,5 herë, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020, por është 10% më pak se viti 2019, që ishte një vit pa problematikat e krijuara nga Covid-19.

Pra, shumë turistë zgjodhën ta vizitonin vendin tonë edhe pse me kufizime. Me ritmet e larta të vaksinimit si dhe me arritjen e imunitetit të masës, Shqipëria arriti të realizonte një promovim të mirë për të tërhequr turistë të huaj.

E përtej Covid-19, Ministria e Shëndetësisë ka role të tjera, të shumta, për të garantuar një sezon turistik cilësor në aspektin e shëndetit të popullatës dhe turistëve.

## SHËRBIMI SHËNDETËSOR NË ZONAT TURISTIKE.

Në shumë nga zonat turistike të vendit shërbimi shëndetësor nuk është një shërbim që ofrohet në mënyrë konstante. Ndaj, më 10 maj Ministri përgjegjës dha urdhrin për organizimin e shërbimit shëndetësor në qendrat shëndetësore që do të funksionojnë pranë zonave turistike të vendit gjatë sezonit veror 2021. E megjithatë urdhri për hartimin e një udhëzuesi mbi organizimin, funksionimin dhe procedurat e ofrimit të shërbimit pranë qendrave shëndetësore verore, u dha me 2 qershor, pra ndërkohë që sezoni turistik kishte filluar.

Më 13 qershor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu inspektoi punimet në qendrën shëndetësore të Ishmit, në Durrës, e cila po ndërtohej nga e para, pas shkatërrimit nga tërmeti i 26 nëntorit. Ndërkohë që Ministria vizitonte qendrën e Ishmit, në Velipojë zhvillohej një protestë që vinte pas humbjes së jetës së një pushuesi 40-vjeçar nga Fushë Kosova. Pushuesit ngrinin disa shqetësime, ku ndër të tjera, theksohej se ambulanca kishte mbërritur një orë me vonesë në vendin e ngjarjes.

Pa humbur kohë, reagoi edhe Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër që njoftonte se Qendra Shëndetësore Verore do niste të funksiononte po atë ditë, dy ditë para datës së parashikuar.

Mos ndoshta Ministria nuk e dinte se sezoni turistik në Shqipëri nis para datës 15 qershor!? Pushuesi ndërroi jetë nga infarkti i miokardit e sikur



## Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Shkodër

21 m · 🌐

🚫 Nisur nga shqetësimet e krijuara ditët e fundit Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër njofton gjithë pushuesit e plazhit të Velipojës që Qendra Shëndetësore Verore në plazh është hapur që sot; dy ditë përpara datës së parashikuar.

📍 Gjithë pushuesit që shfaqin problematika shëndetësore mund të drejtohen pranë kësaj qendre që është në gatishmëri me ekip mjekësor dhe të gjitha medikamentet e nevojshme.

#SezonTuristikSigurt

Shërbimi i Urgjencës të arrinte në kohë, i ndjeri mund të kishte mundësi për të shpëtuar.

Qëndresa Qytetare iu drejtua institucioneve përgjegjëse me një kërkesë për informacion për të mësuar më shumë mbi organizimin e shërbimit shëndetësor në këto zona turistike.

Në të gjithë vendin këtë sezon ishin plot 29 pika turistike që mbuluan shërbim mjekësor në 19 Qendra Shëndetësore.

### Pikat turistike ishin:

*Razëm, Valbonë, Tamarë, Theth, Plazh Currila, Plazh Gjiri i Lalzit, Plazhi Darzezë, Plazhi Zvërnec, Plazhi Qeparo, Plazhi Pogradec, Plazhi Rrjoll, Plazhi Tale, Plazhi Velipojë, Plazhi Shëngjin, Plazhi Durrës, Plazhi Shkëmbi i Kavajës, Plazhi Golem, Plazhi Mali i Robit, Plazhi Divjakë, Plazhi i Vjetër Vlorë, Plazhi Rradhimë, Plazhi Dhërmi, Plazhi Dhrimadhes, Plazhi Himarë, Plazhi Orikum, Plazhi Ksamil 1, Plazhi Ksamil 2, Plazhi Borsh, Plazhi Palasë.*

Shërbimi mjekësor në këto pika turistike u ofrua nga 66 mjekë dhe 67 infermierë dhe ofrimi i shërbimit shëndetësor ka nisur më 15 qershor 2021, sipas Ministrisë së Shëndetësisë.

Në zonat Razëm, Tamarë, Theth, Plazhi Currila, Plazhi Gjiri i Lalzit, Plazhi Darzezë, Plazhi Zvërnec, Plazhi Qeparo, Plazhi Pogradec, Plazhi Rrjoll, Plazhi Tale, shërbimi shëndetësor është ofruar nga 15 qershori deri më 31 gusht 2021.

Në zonat Plazhi Velipojë, Plazhi Shëngjin, Plazhi Durrës, Plazhi Shkëmbi i Kavajës, Plazhi Golem, Plazhi Mali i Robit, Plazhi Divjakë, Plazhi i Vjetër Vlorë, Plazhi Rradhimë, Plazhi Dhërmi, Plazhi Dhrimadhes, Plazhi Himarë, Plazhi Orikum, Plazhi Ksamil 1, Plazhi Ksamil 2, Plazhi Borsh, Plazhi Palasë, shërbimi shëndetësor ofrohet nga 15 qershori deri më 15 shtator.

Në të gjithë pikat Verore Turistike, që nga fillimi i ofrimit të shërbimit deri më 12 shtator 2021 janë kryer në total 45 701 vizita mjekësore, nga të cilat në muajin qershor janë kryer 3687, në muajin korrik janë kryer 17916, në muajin gusht janë kryer 20383 dhe në muajin shtator 3715 vizita mjekësore.



Bazuar në Udhëzuesin mbi organizimin, funksionimin dhe procedurat e ofrimit të shërbimit pranë qendrave shëndetësore verore, në këto pika u ofruan një sërë shërbimesh, si vizita të përgjithshme mjekësore, kujdes në rastet e urgjencave, mjekim dhe trajtim plagësh, procedura mikrokirurgjikale, procedura mjekësore diagnostikuese dhe trajtuese (injeksione, aplikime testesh diagnostikuese etj), si dhe promocion dhe edukim shëndetësor.

Përgjatë këtij sezoni veror, edhe në qendrat shëndetësore verore turistike, është ofruar shërbimi i testit të shpejtë COVID-19. Në total deri më 12 shtator janë kryer 2509 teste të shpejta, nga të cilët kanë rezultuar pozitiv 592 qytetarë të paraqitur në këto qendra. Theksojmë se të dhënat e mësipërme janë marrë nga raportimet e kryera nga Drejtoritë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, të cilat mbulojnë këto Qendra Verore Turistike.

Në anën tjetër, përgjegjësi shumë të madhe, jo vetëm gjatë sezonit turistik, ka edhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor.

## **PO INSPEKTORIATI SHTETËROR SHËNDETËSOR, A ARRIN TË GARANTOJË ZBATIMIN E PROTOKOLLOVE QË LIDHEN ME SHËNDETIN E MIRËQËNIEN?**

Inspektoriatit është një trupë inspektuese që garanton zbatimin e rregullave të detyrueshme në veprimtarinë e përditshme të bizneseve dhe individëve. Pra, më konkretisht ISHSH bën inspektime në terren për të vëzhguar sa zbatohen protokollat e ndryshme që kanë lidhje me shëndetin dhe mirëqënien. Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike, i cili kryhet nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

Objekt i punës së inspektoriatit shtetëror\_shëndetësor është edhe inspektimi i qendrave shëndetësore. ISHSH, ka kryer 58 inspektime dhe monitorime në qendrat shëndetësore në periudhën 12 mars 2020 – 31 gusht 2021. Inspektimet dhe monitorimet kanë pasur qëllim zbatimin e legjislacionit në fuqi mbi të cilin bazohet funksionimi i qendrave shëndetësore, inspektimi i të cilave është përgjegjësi e ISHSH.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka vendosur një masë administrative ndaj qendrës shëndetësore **Cakran në Fier** e cila është gjetur në shkelje. Masa administrative ka qënë paralajmërim dhe është vendosur për prezencë në ambiente të mbyllura të një pjese të personelit dhe pacientësh pa maska. Duket pak si i çuditshëm ky rast, pasi në qendrat shëndetësore dhe në struktura të tjera shëndetësore, të gjesh pacientë pa maska është totalisht e zakonshme, si dhe personeli nuk i kushton rëndësinë e duhur zbatimit të protokollit të posaçëm për covid-19.

Qëndresa Qytetare i dërgoi dhe një kërkesë për informacion ISHSH në lidhje me monitorimin që ato kryejnë në subjekte hotele dhe restorante. Në përgjigjen mjaft të cunguar të institucionit thuhet se në periudhën qershor - gusht janë kryer 2790 inspektime dhe monitorime në subjekte hotele dhe restorante.

Në të njëjtën periudhë janë vendosur 102 masa administrative ndaj këtyre subjekteve. Por, ISHSH duket ka harruar se tjetër përgjegjësi e këtij institucioni është transparenca e plotë online në lidhje me këto inspektime që ato kryejnë. Në rrjete sociale ato janë mjaft aktivë, duke 'raportuar' me foto çdo ditë mbi 'punën' e tyre, por mungon transparenca mbi masat e marra.

Një nga detyrat e Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor është dhe bashkërendimi i veprimtarisë së laboratorëve duke siguruar kryerjen e analizave nga laboratorë të akredituar.

## LABORATORËT E LIÇENSUAR PËR TESTIMIN COVID-19, PUBLIK VS PRIVAT.

Në fillim të pandemisë, testimi për covid-19 ishte i mundur vetëm në strukturat publike. Siç është evidentuar edhe më përpara në raportet e publikuara nga Qëndresa Qytetare, numri i testeve ishte shumë i ulët dhe për pasojë qytetarët kaluan një periudhë pasigurie pasi Instituti i Shëndetit Publik nuk kishte kapacitete të testeve çdo person, duke bërë që njerëzit të nisnin mjekimin pa u konfirmuar pozitiv.

Po ashtu, vonesat në kohë të lajmërimit të pacientëve që kryenin testimin nga ISHP për shkak të mungesës së kapaciteteve sollën rritjen e numrit të pacientëve që zgjodhën t'i drejtoheshin institucioneve shëndetësore jopublike.

Në asnjë moment qeveria nuk mendoi të shtonte kapacitetet e laboratorëve jopublikë për të përballuar rastet e shumta, gjë kjo që do të ndihmonte në përballimin e kostove të shumta financiare për qytetarët.

Në 23 korrik të 2020, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale urdhëroi miratimin e procedurës së kryerjes së testimeve molekulare RT-PCR për SARS-CoV-2 dhe njohjen e laboratorëve jopublikë për kryerjen e testimit **për nevoja administrative** të qytetarëve.

Pika 3 e nenit 9 të Ligjit Nr. 15/2016 thotë: “Identifikimin e shkaktarëve të sëmundjeve infektive, me qëllim përcaktimin e diagnozës, e kryejnë institucionet shëndetësore publike e jopublike të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi për liçencimin.”.

Megjithatë, shprehja për nevoja administrative nuk u shpjegua në urdhrin e ministrit përgjegjës duke lënë hapësirë për keqinterpretim. Në fillim mendohej se laboratorët do testonin qytetarët vetëm për qëllime udhëtimi, ndërsa në fund të vitit Instituti i Shëndetit Publik filloi të raportojë edhe testet e kryera në sektorin privat në statistikat e testimit zyrtar, duke mos bërë një ndarje mes publikes e private.

Deri sot, janë plot 12 laboratorë që kanë plotësuar kriteret për kryerjen e testit RT-PCR.<sup>1</sup>

	<b>Laborator</b>	<b>Numri.i License</b>
<b>1</b>	Intermedica Center sh.p.k,	LN – 8598-09-2019
<b>2</b>	GENIUS LAB,	LN – 7116-04-2019
<b>3</b>	German Hospital International	LN – 6789-02-2019
<b>4</b>	Biocheck Diagnostic	LN-7790-04-2014
<b>5</b>	“SALUS TIRANA” sh.a	LN – 3001-04-2017
<b>6</b>	Noval Diagnostic sh.p.k	LN – 1174-09-2020
<b>7</b>	PEGASUS MED sh.p.k	LN – 6050-01-2013
<b>8</b>	Clinical Cambridge Laboratories sh.p.k	LN-1622-12-2020
<b>9</b>	Orion Struga	LN-2073-03-2021
<b>10</b>	Mario Pipero Person Fizik	LN-2907-09-2021
<b>11</b>	SOMBRERO	LN-2890-09-2021
<b>12</b>	AMERICAN HOSPITAL Laboratori Qendror,	LN-1953-08-2016

<sup>1</sup> <https://shendetesia.gov.al/mbi-njohjen-e-strukturave-jopublike-per-kryerjen-e-testit-rt-pcr/>



Çështja e laboratorëve është marrë në shqyrtim edhe nga auditi i fundit i KLSH që na tregon se në Shqipëri nuk ka asnjë laborator mjekësor të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimi (DPA), por vetëm të licencuar nga MSHMS për testimin covid-19.

DPA është një drejtori pranë Ministrisë së Ekonomisë që akrediton sipas standarteve ISO laboratorët përkatëse. Bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibrues.

Grupi i auditimit i KLSH, mendon se është përjashtuar DPA-ja nga e drejta e saj ligjore, sanksionuar kjo edhe në konventat ndërkombëtare për akreditimin e laboratorëve, gjë e cila do kishte sjellë njohjen e dokumentacionit dhe rezultateve të lëshuara nga këto laboratorë.

KLSH thekson se marrja e kompetencave nga Komiteti i Ekspertëve dhe MSHMS-ja, ka sjellë përjashtim të padrejtë të DPA-së duke cënuar vërtetësinë e të dhënave laboratorike për Covid-19, duke sjellur zbatimin e dy standardeve në këtë proces, i cili ka të bëjë me akreditimin e laboratorëve mjekësorë brenda spitaleve private dhe akreditimin e laboratorëve mjekësorë jashtë tyre, pa përjashtuar faktin që këta laboratorë janë të pa akredituar për testimin RT-PCR për SARS-COV-2.

Në një deklaratë të nëntorit të 2018, Kryeministri Rama shprehej se shëndetësia falas është ylli polar i qeverisë. Qeveria vazhdon ta përmendë shëndetësinë falas që në 2013, kur erdhi në pushtet, por pa një afat të caktuar se kur mund të realizohet.

Sipas nenit 4 të ligjit nr 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", disa nga parimet kryesore për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive janë si më poshtë:

- Zbatimi i parimit të ofrimit falas për çdo person;
- Çdo person ka të drejtë të përfitojë nga masat për mbrojtjen nga sëmundjet infektive;
- Çdo person i sëmurë nga sëmundjet infektive me karakter epidemik ka të drejtën dhe detyrimin të mjekohet falas në çdo institucion shëndetësor publik apo jopublik;
- Çdo personi të dyshuar ose të konfirmuar me sëmundje infektive, sipas një liste të përcaktuar nga Shërbimi Kombëtar i Inteligjencës

Epidemike dhe Shërbimi Kombëtar i Kujdesit ndaj Sëmundjeve Infektive, të miratuar me urdhër nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, i ofrohet shërbim shëndetësor i menjëhershëm dhe falas, pavarësisht nivelit të kujdesit shëndetësor.

Kjo do të thotë se çdo individ i ofrohet shërbim shëndetësor i menjëhershëm dhe falas, pavarësisht nivelit të kujdesit shëndetësor, duke pasur të drejtën dhe detyrimin të mjekohet falas në çdo institucion shëndetësor publik apo jopublik.

E megjithatë, shqiptarët e dijnë mirë sa shtrenjtë i ka kushtuar covid, në terma financiarë. Duke mos dashur të analizojë për herë të dytë kostot e mjekimit, Qendresa Qytetare mori në analizë kostot e testimit dhe përfitimet që patën këto laboratorë.

Deri në nëntor të 2020, kostoja për një test PCR në laborator privat ishte rreth 120 mijë lekë të vjetra. Në nëntor ky çmim u ul në 85 mijë lekë. Sot, çmimi i testit RT-PCR (tamponi) varion nga 5.500 në 6.500 lekë ndërsa ndërsa çmimi i testit të shpejtë varion nga 2.000 në 2.500 lekë.

Ulja e çmimit të testimit nuk erdhi asnjëherë si kërkesë e Ministrisë por nga vullneti i laboratorëve vetë. Ligjet për shërbimin shëndetësor shprehen qartazi se në Shqipëri shërbimi mjekësor është një e mirë publike që ofrohet falas për qytetarët. Në këtë kuadër, MSHMS duhet të ndërhynte duke menduar rimbursimin e plotë ose të pjesshëm të këtij shërbimi që ka rënduar xhepin e qytetarëve, gjë kjo e bërë prezente dhe në kanalet e mediave.


Sipas një investigimi të Reporter.al<sup>2</sup>, shqiptarët shpenzuan së paku 92 milionë euro gjatë vitit 2020 për shërbime spitalore dhe diagnostikuese private me një rritje prej afro 15 milionë eurosh ose 19%, sipas të dhënave financiare të 11 kompanive të analizuar. Pjesa më e madhe kësaj rritjeje duket se erdhi nga shpenzimet e shqiptarëve për analiza, veçanërisht në kompanitë e licencuara për analiza të covid-19.

---

<sup>2</sup> <https://www.reporter.al/shqiptaret-shpenzuan-mbi-90-milione-euro-per-sherbime-mjekesore-private-ne-pandemi/>

**Reporter.al**

## Të ardhurat dhe fitimet, shërbime private



Genius Lab, Spitali Gjerman, Intermedica dhe BIOCHECK ishin disa nga laboratorët që panë të ardhurat dhe fitimet e tyre të shumëfishohen gjatë vitit të pandemisë. Spitali Gjerman rriti të ardhurat me shtatë herë, ndërsa Genius Lab me pesë herë. Intermedica shënoi rritje të fitimeve me 2.7 herë.

Mungesa e fondeve të mjaftueshme për shëndetësinë është një nga sfidat më të mëdha me të cilat është përballur sistemi shëndetësor në vite, ndërkohë që popullata është ende larg përfundimit të një shërbimi shëndetësor cilësor dhe falas.

Raporti i titulluar “Ndikimi i COVID-19 në sistemet shëndetësore në Ballkanin Perëndimor”, i Bankës Botërore, konstaton: “Përpara shpërthimit të COVID-19, sistemet shëndetësore të Ballkanit Perëndimor përballëshin me vështirësi kritike në financim dhe në realizim të shërbimeve. Shpenzimet për frymë për sistemet shëndetësore janë ndjeshëm më të ulëta se mesatarja e BE-së dhe mënyra me të cilën shpenzohen fondet e pakta është jo efikase ose jo e harmonizuar me profilin e sëmundshmërisë në rajon. Kjo e bën këtë rajon të cenueshëm nga shpërthime të ardhshme epidemish, sidomos duke pasur parasysh se pacientët me sëmundje jo ngjitëse janë më të cenueshëm. Qeveritë e Ballkanit Perëndimor do të duhet të sigurojnë fonde për të financuar sistemet shëndetësore për t’i bërë më të forta përballë epidemive në të ardhmen”.

Në të dhënat që Banka jep për vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria ka performancën më të keqe, pasi banorët shpenzojnë nga xhepi për shërbime shëndetësore më shumë se të gjithë (të dhënat e 2014), ndërsa shteti ka shpenzimet më të ulëta për frymë për sistemin e shëndetësisë. Shpenzimet e drejtpërdrejta nga xhepi arrijnë 50% për shqiptarët, më të lartat në rajon dhe në krahasim me mesataren europiane, ndërsa shpenzimet publike për frymë për shëndetësinë ishin 304 dollarë, më të ulëtat në rajon dhe shumë poshtë mesatares së vendeve të BE-së.

## Gjetjet kryesore

- Gjatë vitit 2021 turizmi shqiptar filloi të normalizohej por Shqipëria nuk maksimizoi dot përfitimet nga turizmi për shkak të kufizimeve anti – covid sic ishte ora policore.
- 
- Ministria e Shëndetësisë nxorri në datën 2 qershor urdhrin për hartimin e një udhëzuesi mbi organizimin, funksionimin dhe procedurat e ofrit të shërbimit pranë qendrave shëndetësore verore, pra ndërkohë që sezoni turistik kishte filluar dhe qendrat duhet të ishin gati.
- 
- Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, ka kryer 58 inspektime dhe monitorime në qendrat shëndetësore në periudhën 12 mars 2020 – 31 gusht 2021, duke vendosur vetëm një masë administrative ndaj qendrës shëndetësore **Cakran në Fier** e cila është gjetur në shkelje, për prezencë në ambiente të mbyllura të një pjese të personelit dhe pacientësh pa maska.
- 
- Në lidhje me monitorimin që ISHS kryen në subjekte hotele dhe restorante, institucioni thotë se në periudhën qershor - gusht janë kryer 2790 inspektime dhe monitorime, duke vendosur 102 masa administrative ndaj këtyre subjekteve.
- 
- Sipas KLSH Shqipëria nuk ka asnjë laborator mjekësor të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimi (DPA) për kryerjen e testeve molekulare RT-PCR për SARS-CoV-2 por vetëm të liçencuar nga MSHMS, duke cënuar vërtetësinë e të dhënave laboratorike për Covid-19.
- 
- Sipas Reporter.al shqiptarët shpenzuan 92 milionë euro gjatë vitit 2020 për shërbime spitalore dhe diagnostikuese private me një rritje prej afro 15 milionë eurosh ose 19%. Praktika e përballimit të kostove financiare nga vetë qytetaret bie ndesh me ligjin nr 15/2016 për parandalimin e infeksioneve, që garanton shërbim shëndetësor të menjëhershëm dhe falas.

## REKOMANDIME

- Në sezonin e verës apo edhe gjatë vitit, në kushte kur vendi paraqitet në një situatë të mirë epidemiologjike, komiteti teknik duhet të rekomandojë heqjen e masave të panevojshme dhe ministria duhet të veprojë me një strategji hapjeje.
- 
- MSHMS duhet të përgatitet përpara sezonit veror turistik i cili fillon para datës 15 qershor dhe të sigurojë mirëorganizimin e funksionimin e plotë të shërbimit në qendrat shëndetësore verore që në gjysmën e dytë të majit.
- 
- Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi monitorimit të zbatimit të protokolleve anti-covid, sidomos në strukturat që ofrojnë shërbim shëndetësor. Gjithashtu, ISHSH duhet të bëjë transparencë të plotë online për inspektimet që kryen si dhe për masat administrative që ndërmer.
- 
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik duhet të marrin masat për vënien në eficiencë të plotë të laboratorëve të shëndetit publikë me pajisjet që nevojiten për të evidentuar shkaqet e sëmundjeve infektive, si edhe rritjen e numrit të tyre për përballimin e epidemive.
- 
- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit duhet bërë pjesë e procesit të liçensimit dhe akreditimit të laboratorëve jopublike duke i garantuar të drejtën e saj ligjore, sanksionuar kjo edhe në konventat ndërkombëtare për akreditimin e laboratorëve, gjë e cila do sjellë dhe njohjen e dokumentacionit dhe rezultateve të lëshuara nga këto laboratorë.
- 
- MSHMS duhet të ndërhyjë duke menduar rimbursimin e plotë ose të pjesshëm të çdo shërbimi mjekësor në privat që rëndon xhepin e qytetarëve.



# #QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

Ky raport publikohet në kuadër të nismës së Qëndresës Qytetare për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED)

Analistët e rinj të politikave publike të angazhuar në këtë nismë do të prodhojnë raporte monitoruese periodike në fushat kryesore të qeverisjes dhe do të angazhohen në përpjekje për avokim me zyrtarë të shtetit, ligjvënësit, ekspertë dhe shoqërinë civile për të promovuar rekomandime që do të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe qeverisë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Qëndresës Qytetare.